



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Ekstra 58

Korrik

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.591, datë 5.9.2007	Për përcaktimin e personaliteteve të tjera të larta shtetërore të vendit, që do të ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë	3
Vendim i KM nr.592, datë 5.9.2007	Për përcaktimin e personaliteteve të tjera të larta shtetërore të vendit, që do të ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë edhe pas lirimit nga funksioni	4
Vendim i KM nr.593, datë 5.9.2007	Për dhënie ndihme financiare familjes të së ndjerës Altina Tomorri, që humbi jetën nga zjarret, që përfshinë ditët e fundit, Greqinë	4
Vendim i KM nr.596, datë 5.9.2007	Për ngritjen e strukturave dhe përcaktimin e autoriteteve e të përgjegjësive për zbatimin e instrumentit të parazgjerimit	5
Vendim i KM nr.598, datë 5.9.2007	Për mbylljen e veprimtarisë ekonomiko-financiare të ndërmarrjes shtetërore “Shtypshkronja e Bankës së Shqipërisë”	6
Vendim i KM nr.613, datë 12.9.2007	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve, për kurimin e znj.Polixseni Ndrenika, në Greqi	9
Vendim i KM nr.614, datë 12.9.2007	Për dhënien në përdorim Agjencisë së Prokurimeve Publike të disa mjediseve të ndërtesës (godinës) së ish-INIMA-s	9
Vendim i KM nr.615, datë 19.9.2007	Për lirim nga detyra	11
Vendim i KM nr.622, datë 27.9.2007	Për organizimin e ceremonisë mortore në nderim të At Zef Pllumi	11

Vendim i KM nr.661, datë 18.10.2007	Për përcaktimin e masave për organizimin e qendrave ose të instituteve të kërkimit dhe zhvillimit, për fillimin e veprimtarisë në periudhën kalimtare.....	12
Vendim i KM nr.665, datë 10.10.2007	Për një shtesë në vendimin nr.579, datë 8.9.1998 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e rregullave për kthimin e vlerave financiare të kreditorëve, që kanë depozituar kapitalet e tyre pranë shoqërive huamarrëse”, të ndryshuar	12
Vendim i KM nr.675, datë 19.10.2007	Për dhënie ndihme financiare, znj.Luljeta Rugji.....	13
Vendim i KM nr.676, datë 24.10.2007	Për emërim në detyrë	14
Vendim i KM nr.695, datë 24.10.2007	Për lirim dhe emërim në detyrë	14
Vendim i KM nr.696, datë 19.10.2007	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Vau i Dejës të qarkut të Shkodrës	15
Vendim i KM nr.730, datë 7.11.2007	Për dhënien në përdorim Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Ministrisë së Integritetit, Avokatit të Prokurimeve Publike, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe Agjencisë së Prokurimeve Publike të disa mjediseve të ndërtesës (godinës) së ish-INIMA-s	16
Vendim i KM nr.740, datë 7.11.2007	Për lirim dhe emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Beratit	19
Vendim i KM nr.741, datë 7.11.2007	Për emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Vlorës	19
Vendim i KM nr.743, datë 13.11.2007	Për propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të kandidaturave alternative për anëtarë të Komisionit të Shërbimit Civil	19
Vendim i KM nr.745, datë 7.11.2007	Për miratimin e planit kombëtar të veprimit, për dërgesat në para të emigrantëve	20
Vendim i KM nr.776, datë 14.11.2007	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z.Ismail Kadare.	20
Vendim i KM nr.843, datë 29.11.2007	Për miratimin e programit, ekonomik dhe fiskal, afatmesëm, të Shqipërisë, 2007-2010	21
Vendim i KM nr.845, datë 29.11.2007	Për dhënie fondi ndihme Partisë së të Drejtave të Mohuara e Re..	21

Vendim i KM nr.848, datë 21.11.2007	Për heqjen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme, në administrim të Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik, të pasurisë, ndërtesë dhe truall, “Ambasada çeke”, në rrugën “Skënderbej”, nr.10, Tiranë, dhe kalimin e saj në fondin e kompensimit fizik, në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	22
Vendim i KM nr.853, datë 14.11.2007	Për përdorimin e llambave fluoreshente kompakte të ndriçimit ...	24
Vendim i KM nr.863, datë 5.12.2007	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve, për kurimin e z.Sherif Sulejmani, në Greqi	24
Vendim i KM nr.891, datë 19.12.2007	Për kalimin e një sipërfaqeje, pronë shtetërore, në fondin e kompensimit fizik dhe vënien e saj në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	25
Vendim i KM nr.893, datë 29.12.2007	Për dhënien e një ndihme financiare z.Kristaq Eksarko	30
Vendim i KM nr.894, datë 29.12.2007	Për dhënien e një ndihme financiare familjes së shtetasit Sami Doga	30
Vendim i KM nr.895, datë 29.12.2007	Për dhënie ndihme financiare familjes së Kei Robert Koçiu	31
Vendim i KM nr.896, datë 29.12.2007	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve për kurimin e z.Hazis Meta	31
Vendim i KM nr.897, datë 29.12.2007	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve, për kurimin e znj.Arminda Gjoni, në Turqi	32
Vendim i KM nr.898, datë 29.12.2007	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve, për kurimin e ish-dekanit të Fakultetit të Mjekësisë, në Universitetin e Tiranës, prof.dr.Kristo Pano	32
Vendim i KM nr.921, datë 29.12.2007	Për disa ndryshime në vendimin nr.108, datë 11.2.2005 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e organizimit, të funksionit dhe pagat e punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave”, të ndryshuar	33

VENDIM
Nr.591, datë 5.9.2007

PËR PËRCAKTIMIN E PERSONALITETEVE TË TJERA TË LARTA SHTETËRORE TË VENDIT, QË DO TË RUHEN DHE MBROHEN NGA GARDA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c” të nenit 4 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë“, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Garda e Republikës së Shqipërisë do të ruajë dhe mbrojë edhe këto personalitete të larta shtetërore të vendit:

- a) Prokurorin e Përgjithshëm dhe Ministrin e Brendshëm, me eskortë;
- b) Zëvendëskryeministrin, Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, Kryetarin e Gjykatës së Lartë, Kryetarin e Kontrollin të Lartë të Shtetit, Drejtorin e Shërbimit Informativ të Shtetit dhe kryetarin e maxhorancës parlamentare, me shoqërim, me oficer e nënoficer, shoqërues;
- c) Zëvendëskryetarët e Kuvendit, me nënoficer shoqërues;
- ç) Anëtarët e Këshillit të Ministrave, për të cilët nuk janë parashikuar masa ruajtjeje e mbrojtjeje në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij vendimi, dhe guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, me shofer shoqërues;
- d) Kryetarin e bashkisë së Tiranës, me oficer shoqërues;
- dh) Kryetarin e partisë më të madhe të maxhorancës parlamentare, me shoqërim, me oficer e nënoficer shoqërues;
- e) Kryetarin e partisë më të madhe të opozitës parlamentare, me oficer shoqërues.

2. Vendimet nr.310, datë 14.5.2004, dhe nr.93, datë 11.2.2005 të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm dhe komandanti i Gardës së Republikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.592, datë 5.9.2007

**PËR PËRCAKTIMIN E PERSONALITETEVE TË TJERA TË LARTA SHTETËRORE TË
VENDIT, QË DO TË RUHEN DHE MBROHEN NGA GARDA E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË EDHE PAS LIRIMIT NGA FUNKSIONI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Garda e Republikës së Shqipërisë do të ruajë dhe mbrojë pas lirimit nga funksioni, edhe këto personalitete të larta shtetërore:

- Prokurorin e Përgjithshëm;
- Ministrin e Brendshëm.

2.Personalitetet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, ruhen dhe mbrohen, me shoqërim, me oficer e nënoficer shoqërues, edhe 2 (dy) muaj pas lirimit nga funksioni.

3.Vendimet nr.310, datë 14.5.2004 dhe nr.93, datë 11.2.2005 të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

4.Ngarkohen Ministri i Brendshëm dhe komandanti i Gardës së Republikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.593, datë 5.9.2007

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES TË SË NDJERËS ALTINA TOMORRI, QË
HUMBI JETËN NGA ZJARRET, QË PËRFSHINË DITËT E FUNDIT, GREQINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë“, të ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e një ndihme financiare prej 1 000 000 (një milion) lekësh, familjes të së ndjerës Altina Tomorri, banore e fshatit Velmish, në komunën Strumë të qarkut të Fierit, që humbi jetën nga zjarret, që ranë ditët e fundit, në Greqi.

2. Prefektit të qarkut të Fierit, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, t’i shtohet fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh, të cilin t’ia japë përfaqësuesit të familjes së viktimës, në përputhje me dokumentet dhe procedurat ligjore në fuqi.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
4. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm dhe prefekti i qarkut të Fierit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.596, datë 5.9.2007

PËR NGRITJEN E STRUKTURAVE DHE PËRCAKTIMIN E AUTORITETEVE E TË PËRGJEGJËSIVE PËR ZBATIMIN E INSTRUMENTIT TË PARAZGJERIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrisë të Integritimit dhe të Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Strukturat, autoritetet dhe përgjegjësitë për zbatimin e Instrumentit të Parazgjerimit (IPA) janë, si më poshtë vijon:

a) Ministri i Integritimit caktohet Koordinator Kombëtar i Instrumentit të Parazgjerimit (IPA) dhe do të udhëheqë procesin e programimit të fondeve të Bashkimit Europian.

b) Ministri i Financave caktohet zyrtar përgjegjës akreditues dhe është përgjegjës për monitorimin e plotësimit të kërkesave për akreditimin e zyrtarit kombëtar të autorizuar dhe të fondit kombëtar.

c) Zëvendësministri i Financave caktohet zyrtar kombëtar i autorizuar dhe njëkohësisht, është edhe kryetar i fondit kombëtar.

ç) Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave caktohet zyrtar i autorizuar i programit.

d) Njësia e financimeve dhe e kontraktiveve, në Ministrinë e Financave, shërben si njësi qendrore për financim dhe kontraktim.

dh) Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit shërben si fond kombëtar dhe është përgjegjëse për menaxhimin financiar të asistencës së programit IPA.

e) Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit shërben si autoriteti i auditimit dhe është përgjegjëse për verifikimin e funksionimit efektiv të sistemit të kontrollit dhe menaxhimit të zbatimit të programit IPA.

2. Ministria e Integritimit identifikon përparësitë për financim nga programi IPA, në bashkëpunim me ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore. Për përparësitë e identifikuar bëhen këshillime me Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj dhe Ministrinë e Financave dhe më pas i paraqiten për miratim Komitetit të Planifikimit Strategjik. Ministria e Integritimit u përcjell Shërbimeve të Komisionit Europian përparësitë, të miratuara për financim nga Komiteti i Planifikimit Strategjik.

3. Njësia e menaxhimit të projekteve për programin e zhvillimit të komuniteteve vendore, në varësi të Ministrisë së Integritimit, transferohet në Ministrinë e Financave. Kjo njësi rristrukturohet, në përputhje me rolin e funksionet e njësisë qendrore për financim dhe kontraktim.

4. Zbatimi i programit të zhvillimit të komuniteteve vendore do të bëhet sipas strukturave dhe autoriteteve të përcaktuara në këtë vendim, për zbatimin e Instrumentit të Parazgjerimit (IPA).

5. Ngarkohet Ministria e Integritit, nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit, të kryejë programimin e fondeve të Bashkimit Europian, për programin e zhvillimit të komuniteteve vendore.

6. Ngarkohen Ministria e Integritit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

7. Urdhri nr.154, datë 13.7.2006 i Kryeministrit “Për caktimin e koordinatorit kombëtar në programin “Instrumenti i Ndhmës së Paraaderimit” të Bashkimit Europian”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.598, datë 5.9.2007

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË EKONOMIKO-FINANCIARE TË NDËRMARRJES
SHTETËRORE “SHTYPSHKRONJA E BANKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31 të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e veprimtarisë ekonomiko-financiare të ndërmarrjes shtetërore “Shtypshkronja e Bankës së Shqipërisë”, në varësi administrative të Bankës së Shqipërisë.

2. Punonjësit, që dalin të papunë nga mbyllja e kësaj ndërmarrjeje, të trajtohen në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës.

3. Banka e Shqipërisë, si institucion përgjegjës, të bëjë likuidimin e shumave të pagesave përkatëse, në bazë të listëpagesave, të paraqitura në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Periudha gjatë së cilës punonjësit e kësaj ndërmarrjeje do të marrin pagesën e përcaktuar në këtë vendim, të njihet si periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni pleqërie, invaliditeti dhe familjar, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Pas mbarimit të trajtimit, të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, punonjësit të trajtohen me pagesë papunësie, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Detyrimet kontabile, që ndërmarrja shtetërore “Shtypshkronja e Bankës së Shqipërisë” ka ndaj të tretëve, deri në çastin e mbylljes së veprimtarisë, të përballohen nga vetë ndërmarrja.

6. Detyrimet kontabile, që të tretët kanë ndaj kësaj ndërmarrjeje, deri në çastin e mbylljes së veprimtarisë, të ndiqen për t’u arkëtuar nga Ministria e Financave. Fondet e arkëtuara derdhen në Buxhetin e Shtetit.

7. Ngarkohet Banka e Shqipërisë, që në përputhje me vendimin nr.153, datë 3.4.1993 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e objekteve, të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore”, të kryejë transferimin e kapitaleve të patrupëzuara dhe inventarin ekonomik të mjeteve të xhiros së kësaj ndërmarrjeje, sipas aneksit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, në përgjegjësi të Ministrisë së Financave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8. Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve t’i transferohen teknologjia dhe të gjitha makineritë e shtypshkronjës, për shtypjen e pullave fiskale.

9. Ngarkohet Ministria e Financave për shitjen, nëpërmjet ankandit të hapur, të kapitaleve të patrupëzuara të ndërmarrjes. Të ardhurat e realizuara nga kjo shitje t’i kalojnë Buxhetit të Shtetit.

10. Përgjegjësia e administrimit të ndërtesës, ku zhvillon veprimtarinë ndërmarrja shtetërore “Shtypshkronja e Bankës së Shqipërisë“ i mbetet Bankës së Shqipërisë, sipas vendimit nr.762, datë 13.11.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kalojnë në përgjegjësi administrimi Bankës së Shqipërisë“.

11.Ngarkohen Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi më 31 mars 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1
BANKA E SHQIPËRISË
NDËRMARRJA SHTETËRORE “SHTYPSHKRONJA E BANKËS SË SHQIPËRISË
TABELA E EFEKTEVE FINANCIARE PER PAGA + SIGURIME SHOQËRORE
PERIUDHA 1-VJEÇARE

Nr.	Emri Mbiemri	Vite në ndërmarrje	Paga mujore	Paga vjetore	Sigurime shoqërore	Sig. 1-vjeçar	Totali sig. + pagë	Totali sig. + pagë
1	Alfons Theka	18	154000	1848000	20231	242772	2090772	2090772
2	Lumturi Balla	13	104120	1249440	20231	242772	1492212	1492212
3	Saryhan Merdani	12	112480	1349760	20231	242772	1592532	1592532
4	Vjollca Bastari	17	42000	504000	12933	155196	659196	659196
5	Margarita Shyti	17	36000	432000	11085	133020	565020	565020
6	Aleksandër Qirjazi	15	33000	396000	10162	121944	517944	517944
7	Reshit Hoxha	7	33000	396000	10162	121944	517944	517944
8	Beqir Yrsheku	11	36000	432000	11085	133020	565020	565020
9	Vjollca Kallushi	8	40000	480000	12317	147804	627804	627804
10	Afërdita Goga	25	40000	480000	12317	147804	627804	627804
11	Ejup Baftjari	17	40000	480000	12317	147804	627804	627804
12	Vjollca Dobi	25	33000	396000	10162	121944	517944	517944
13	Fidarije Dervishi	16	33000	396000	10162	121944	517944	517944
14	Flutura Selimi	17	36000	432000	11085	133020	565020	565020

15	Mereme Teta	25	23000	276000	7082	84984	360984	360984
16	Donika Hoxha	25	30000	360000	9238	110856	470856	470856
17	Frida Shala	15	30000	360000	9238	110856	470856	470856
18	Nadire Doda	5	30000	360000	9238	110856	470856	470856
19	Liljana Rasha	4	30000	360000	9238	110856	470856	470856
20	Irma Allmeta	4	30000	360000	9238	110856	470856	470856
21	Ferdide Caka	4	30000	360000	9238	110856	470856	470856
22	Mimoza Rexhmati	12	30000	360000	9238	110856	470856	470856
	Shuma		1005600	12067200	256228	3074736	15141936	15141936

ANEKSI 2

Bilanci i ndërmarrjes shtetërore "Shtypshkronja e Bankës së Shqipërisë" në datën 31 Mars 2007			
1. Godina/troje	5,365,290.28	1. Kapitali dhe rezervat	217,987,355.35
Ndertime/rikonstruksione	17,055,811.00	Kapitali i nenshkruar	51,516,720.25
Amortizime	-11,690,520.72	Fitime neto, te mbartura	167,890,915.55
		Humbje te perealizuara (virtuale)	-1,420,280.45
2. Aktive te tjera te qendrueshme	5,795,419.22	Transferim i vleres se godines prane B.SH	-5,365,290.28
Instalime teknike, makineri, pajisje	79,129,402.84	1. Kapitali dhe rezervat pa vleren e godines	212,622,065.07
Amortizime	-74,094,946.33		
Mjete transporti	3,216,172.40	2. Fonde te tjera te vetat	48,938,219.81
Amortizime	-3,216,172.40	Fondi i zhvillimit	24,166,367.60
Paisje zyre/informatike/mobilje/orendi etj	2,965,458.00	Fondi i shperblimit suplementar te punonjesve	141,331.00
Amortizime	-2,204,495.29	Fondi i ndihmave te menjehershme	5,406,365.00
		Fonde te tjera	19,224,156.21
3. Aktive qarkulluese/inventare	24,720,268.63	3. Detyrime afatshkurtra	600,558.00
materiale te para dhe materiale ndihmese	21,565,145.15	Furnitore per blerje e sherbime	260,000.00
produkte te gatshme dhe te ndermjetme	451,994.89	Sigurime shoqerore dhe te ngjashme	283,185.00
gjendje inventari/te tjera	973,356.35	Shteti-tatime dhe taksa	57,373.00
Kliente per shitje, sherbime	1,729,772.24		
4. Likuiditete dhe vlera arke	231,645,155.03	Totali Kapitalit dhe detyrimeve (pa godinen)	262,160,842.88
Depozita ne banke dhe ne llogari te tjera	231,639,058.03		
Para ne dore (arka)	6,097.00	Totali aktiveve (me godinen)	267,526,133.16
		Totali Kapitalit dhe detyrimeve	267,526,133.16

VENDIM
Nr.613, datë 12.9.2007

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE, PËR KURIMIN E ZNJ.POLIKSENI NDRENIKA, NË GREQI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë“, të ndryshuar, dhe të neneve 8 e 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, zëri “Shpenzime për mallra e shërbime”, t’i shtohet fondi prej 1 360 000 (një milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve, për kurimin e znj.Polikseni Ndrenika, në Greqi.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Pagesa të kryhet pas paraqitjes së faturave të shpenzimeve, nga institucioni i kurimit.
4. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.614, datë 12.9.2007

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM AGJENCISË SË PROKURIMEVE PUBLIKE TË DISA MJEDISEVE TË NDËRTESES (GODINËS) SË ISH-INIMA-S


Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr.8743, datë 23.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim Agjencisë së Prokurimeve Publike të disa mjediseve, në katin e dytë, të ndërtesës të ish-INIMA-s, në administrim të Këshillit të Ministrave, sipas vendodhjes së përcaktuar në planimetrinë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Kryeministria dhe Agjencia e Prokurimeve Publike për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Godina 15h. INIMA
KATI II.
Hapsira né dispozicim
te APP



VENDIM
Nr.615, datë 19.9.2007

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Nikolin Jaka, zëvendësministër i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, të lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.622, datë 27.9.2007

PËR ORGANIZIMIN E CEREMONISË MORTORE NË NDERIM TË AT ZEF PLLUMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, dhe të pikës 10 të kapitullit VII të vendimit nr.229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Ceremoniali zyrtar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Organizimin e ceremonisë, jo të plotë zyrtare, në nderim të figurës së spikatur të qëndresës antikomuniste At Zef Pllumi, i cili ndërroi jetë më 25.9.2007, pas një sëmundjeje të rëndë.

2. Ngritjen e një komisioni shtetëror për kryerjen e ceremonisë mortore, në përbërje të të cilit të jenë zëvendëskryetari i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë z.Fatos Beja, zëvendëskryeministri z.Gazmend Oketa, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, z.Ylli Pango, këshilltari i Presidentit për Sigurinë Kombëtare, z.Illir Kulla, znj.ArencaTrashani, deputete, drejtori i Bibliotekës Kombëtare, z.Aurel Plasari, drejtori i Përgjithshëm i Institutit për Integritet e ish-të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë z.Simon Miraka, z.Bardhyl Londo, shkrimtar, z.Fahri Balliu, publicist e botues, dhe një përfaqësues i Protokollit të Shtetit.

3. Trupi i të ndjerit të pritët me ceremoni në aeroportin “Nënë Tereza”, ditën e premte, 28 shtator 2007, ora 14⁰.30.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

5.Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Protokollit i Shtetit për organizimin e ceremonialit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.661, datë 18.10.2007

**PËR PËRCAKTIMIN E MASAVE PËR ORGANIZIMIN E QENDRAVE OSE TË
INSTITUTEVE TË KËRKIMIT DHE ZHVILLIMIT, PËR FILLIMIN E VEPRIMTARISË NË
PERIUdhËN KALIMTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 41 e vijuese të ligjit nr.9741, datë 11.6.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të neneve 8 e 10 të ligjit nr.9465, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Brenda datës 31.12.2007 të përfundojë fillimi i veprimtarisë, për periudhën kalimtare, të qendrave ose instituteve të kërkimit dhe zhvillimit, të krijuara me vendimet nr.146, datë 28.3.2007, nr.178, datë 4.4.2007, nr.559, datë 22.8.2007, nr.560, datë 22.8.2007, nr.561, datë 22.8.2007, nr.562, datë 22.8.2007, nr.563, datë 22.8.2007, të Këshillit të Ministrave.

2. Veprimtaria administrative, shpenzimet për personelin, si dhe shpenzimet e tjera, për funksionimin e institucioneve, sipas pikës të këtij vendimi, deri në përfundimin e organizimit të secilit institucion, të realizohet dhe të përballohet me fondet e vitit 2007, miratuar për Akademinë e Shkencave.

3. Çdo akt për transferimin e numrit të punonjësve dhe të fondeve përkatësisht, për paga dhe sigurime shoqërore, nga Akademia e Shkencave të ministritë e linjës pezullohet, deri në çastin e kalimit të tyre në sistemin e këtyre ministrive dhe fillimin e veprimtarisë, sipas organizimit të përcaktuar me vendimet për krijimin e tyre.

4. Numri maksimal i punonjësve buxhetorë të Akademisë së Shkencave, për këtë periudhë , mbetet 500 veta.

5. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Akademia e Shkencave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.665, datë 10.10.2007

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.579, DATË 8.9.1998 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR CAKTIMIN E RREGULLAVE PËR KTHIMIN E VLERAVE FINANCIARE TË
KREDITORËVE QË KANË DEPOZITUAR KAPITALET E TYRE PRANË SHOQËRIVE
HUAMARRËSE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7 e 13 të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998 “Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë“, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të pikës 11 të vendimit nr.579, datë 8.9.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Kreditorëve, që kapitalet e tyre i kanë depozituar në shoqëritë “Gjallica”, “Beno” e “Nahel” sh.p.k., në administrim, nuk do t’u kërkohet, përjashtimisht, mandatarkëtimi i depozitimit të parave, nga që nuk disponohen në këto shoqëri, për tërheqjen e vlerave financiare pranë sporteleve të bankave.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.675, datë 19.10.2007

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE, ZNJ.LULJETA RUGJI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare, në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë, znj.Luljeta Rugji.

2. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2007, grupi 25, titulli 10430, kap.1, artikulli 606 “Transferta të brendshme”, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.676, datë 24.10.2007

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z.Zef Bushati emërohet zëvendësministër i Integrimit.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.695, datë 24.10.2007

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të neneve 95, pika 2, dhe 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Z.Edi Paloka, drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Telegrafike Shqiptare, lirohet nga kjo detyrë.
2.Z.Artur Kopani emërohet drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Telegrafike Shqiptare.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.696, datë 19.10.2007

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË VAU I DEJËS TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2,3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Vau i Dejës të qarkut të Shkodrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ të bashkisë Vau i Dejës të qarkut të Shkodrës, miratuar me vendimin nr.468, datë 17.6.7.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Vaut të Dejës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Vaut të Dejës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Vau i Dejës

Lidhja nr.1

Numri rendor i pronës në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-13	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
14-20	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
31-311,319	Infrastrukturë (troje të lira)	Në përdorim
24-30	Shërbim funeral	Në pronësi
21-23	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore.	Në pronësi
440	Kullota komunale	Në pronësi
325-331,334,335,337-342,	Zhvillim ekonomik	Në pronësi
312-318,566-828,831-833,836-838	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, trotuar).	Në pronësi
552,553,903,909,911,918,923,924,896	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë	Në pronësi

	dhe të ushqimit (toka joproductive kanale të treta).	
541-551	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim

VENDIM
Nr.730, datë 7.11.2007

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT, MINISTRISË SË INTEGRIMIT, AVOKATIT TË PROKURIMEVE PUBLIKE, QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT DHE AGJENCISË SË PROKURIMEVE PUBLIKE TË DISA MJEDISEVE TË NDËRTESESË (GODINËS) SË ISH-INIMA-S

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr.8743, datë 23.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të disa mjediseve, në katin përdhe të ndërtesës së ish-INIMA-s, në administrim të Këshillit të Ministrave, sipas vendndodhjes së përcaktuar në planimetrinë, në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit do të shfrytëzojnë hapësirat e përbashkëta, sipas planimetrisë, bashkëlidhur vendimit.

2. Dhënie në përdorim Ministrisë së Integrimit të disa mjediseve, në katin përdhe, të ndërtesës së ish-INIMA-s, në administrim të Këshillit të Ministrave, sipas vendndodhjes së përcaktuar në planimetrinë, në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.


3. Dhënie në përdorim Ministrisë së Integrimit, Avokatit të Prokurimeve Publike, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, Agjencisë së Prokurimeve Publike dhe Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit të hapësirave të nevojshme për parkim, sipas vendndodhjes së përcaktuar në planimetrinë, në shtojcën 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Integrimit, Avokati i Prokurimeve Publike, Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe Agjencia e Prokurimeve Publike për zbatimin e këtij vendimi,

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Godina e ish-Ordinatorit Qendror - Kati per dhe Sh 1:200



Siperfaqe e QKR


Siperfaqe e Ministrise se Integritimit

Siperfaqe e perbashket

Siperfaqe e AKSH

Sh 1:200

Godina e ish-Ordinatorit Qendror -Garazhet



VENDIM
Nr.740, datë 7.11.2007

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË BERATIT

Në mbështetje të nenit 114 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- 1.Z.Roland Bejko, prefekt i qarkut të Beratit, lirohet nga kjo detyrë.
 - 2.Z.Thoma Rumniçi emërohet prefekt i qarkut të Beratit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.741, datë 7.11.2007

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË VLORËS

Në mbështetje të nenit 114 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- Z.Xhevahir Rexhepi emërohet prefekt i qarkut të Vlorës.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.743, datë 13.11.2007

**PËR PROPOZIMIN KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË KANDIDATURAVE
ALTERNATIVE PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2 e 6 të nenit 5 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të kandidaturave alternative për anëtar të Komisionit të Shërbimit Civil, si më poshtë vijon:

- Z.Kostandin Kazanxhi;
- Znj.Anila Nepravishhta;

- Z.Riçard Marku.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.745, datë 7.11.2007

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT, PËR DËRGESAT NË PARA TË EMIGRANTËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e planit kombëtar të veprimit, për dërgesat në para të emigrantëve, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2.Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të barabarta, Ministria e Financave, Ministria e Punëve të jashtme, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Banka e Shqipërisë, INSTAT-i dhe Posta Shqiptare sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.776, datë 14.11.2007

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z.ISMAIL KADARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z.Ismail Kadare, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.843, datë 29.11.2007

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT, EKONOMIK DHE FISKAL, AFATMESËM, TË SHQIPËRISË, 2007-2010

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e programit, ekonomik dhe fiskal, afatmesëm, të Shqipërisë, 2007-2010, sipas tekstit dhe relacionit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.845, datë 29.11.2007

PËR DHËNIE FONDI NDIHME PARTISË SË TË DREJTAVE TË MOHUARA E RE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, të ndryshuar, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë“, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Partisë së të Drejtave të Mohuara e Re t’i jepet një fond prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh, si ndihmë financiare.

2.Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3.Ngarkohet Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.848, datë 21.11.2007

**PËR HEQJEN NGA LISTA E INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME, NË
ADMINISTRIM TË DREJTORISË SË SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK, TË
PASURISË, NDËRTESE DHE TRUALL, “AMBASADA ÇEKE”, NË RRUGËN
“SKËNDERBEJ”, NR.10, TIRANË, DHE KALIMIN E SAJ NË FONDIN E KOMPENSIMIT
FIZIK, NË DISPOZICION TË AGJENCISË SË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË
PRONAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16 e 28 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1.Prona truall dhe ndërtesë, me vendndodhje në rrugën “Skënderbej” nr.10, Tiranë, me kufij në veri me pasurinë 1/96, në jug me pasurinë 1/98, në lindje me pasurinë 1/133, në perëndim me pasurinë 1/151 dhe sipas planvendosjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të hiqet nga lista e pronave në administrim të Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik, miratuar me vendimin nr.450, datë 16.6.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik”, dhe të kalojë në fondin e kompensimit fizik, në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave

2.Ministri i Punëve të jashtme, në bashkëpunim me drejtorinë e Përgjithshëm të AKKP-së, harton memorandumun e bashkëpunimit me Ambasadën e Republikën Çeke për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së pronësisë së Republikës Çeke në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

3.Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



PUNOI: H. DERVISHI
 PUNOI: A. PARLLAKU
 VIZATOI: M. LLAHOCRI

SHTATOR 1999



KONTROLLOH:
 INGTANAN RUSI

VENDIM
Nr.853, datë 14.11.2007

PËR PËRDORIMIN E LLAMPAVE FLUORESHENTE KOMPAKTE TË NDRIÇIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9379, datë 28.4.2005 “Për efijencën e energjisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Në të gjitha institucionet publike, shtetërore, dhe ndërmarrjet me kapital shtetëror, buxhetore dhe jobuxhetore, duke filluar nga data 1.4.2008, për ndriçimin e mjediseve të brendshme dhe të mjediseve ndihmëse të tyre të përdoren llamba fluoreshente kompakte “klasi A i energjisë”.

2.Titullarët e të gjitha institucioneve publike, shtetërore dhe të ndërmarrjeve me kapital shtetëror, buxhetore dhe jobuxhetore, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e pikës 1 të këtij vendimi.

3.Kur vihet re se titullari ose personi përgjegjës për çështjet administrative të institucionit nuk ka përmbushur kërkesën e pikës 1 të vendimit, ndaj tij merret masa administrative me gjobë deri në një pagë mujore.

4.Ministria e Financave, brenda datës 30.11.2007, të paraqesë pranë Këshillit të Ministrave aktet e nevojshme ligjore, për stimulimin fiskal të përdorimit të pajisjeve elektroshtëpiake, me efijencë të lartë.

5.Ngarkohen institucionet publike, shtetërore dhe ndërmarrjet, me kapital shtetëror, buxhetore dhe jobuxhetore, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.863, datë 5.12.2007

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE, PËR KURIMIN E Z.SHERIF SULEJMANI, NË GREQI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh, për përballimin e pjesshëm të shpenzimeve, për kurimin e z.Sherif Sulejmani, në Greqi.

2.Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3.Pagesa të bëhet pas paraqitjes së faturave të shpenzimeve nga institucioni i kurimit.

4.Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.891, datë 19.12.2007

**PËR KALIMIN E NJË SIPËRFAQEJE, PRONË SHTETËRORE, NË FONDIN E
KOMPENSIMIT FIZIK DHE VËNIEN E SAJ NË DISPOZICION TË AGJENCISË SË
KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16 e 28 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Sipërfaqja truall, prej 1 185 m², pronë shtetërore, me vendndodhje në Tiranë, ZK 8380, me numër pasurie 2/329, me kufij: në veri, rrugë; në jug, rrugë; lindje, pasuria 2/94; dhe në Perëndim, rrugë, sipas planvendosjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kalojë në fondin e kompensimit fizik e të vihet në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

2.Kjo sipërfaqe të shërbejë për kompensimin fizik të Komunitetit Mysliman Shqiptar, të pronës së njohur me vendimet nr.459, datë 21.2.1996 dhe nr.345, datë 24.9.2000 të ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Tiranë.

3.Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



PLAN VENDOSJA E PRONES


NGA PLANSHETA
TR-

PUNOI : M. KAZAZI

PUNOI : F. LLAGAMI


VIZATOI : M. LLAHOCI

DHJETOR 1999




UNITETIT MYSLYMAN

SH. 1:500




KONTROLLOI:


ING. ATNAN RUSI



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

<p style="text-align: center;">ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË</p> <p style="text-align: center;">REGJISTRUESI FADIL KALOSHI</p> <p style="text-align: center;"><i>Vula</i></p>	<p>A. IDENTIFIKIMI I PASURISE</p> <p>ZONA KADASTRALE <u>3330</u>, NR. PASURISE <u>2/329</u>, VOL. <u>10</u>, FO. <u>25</u> INDEKSI I HARTËS <u>T.E - 0-11</u>, SHKALLA <u>1:500</u> ADRESA E PASURISË: Rrethi <u>TIRANË</u>, QJ <u>TIRANË</u> Rr./V. <u>Konopjat</u>, P/G _____, Sh _____, K _____, A _____</p> <p>B. KUFIZIMET C. PRONARI</p> <p>V. _____ L. _____ J. _____ P. <u>2/94 Tërb. KIRA.</u> P. _____ P. <u>2/329 34 tet.</u> D. Data: <u>13.12.07</u> Or: <u>14</u></p>
--	--





VENDIM
Nr.893, datë 29.12.2007

PËR DHËNIEN E NJË NDIHME FINANCIARE Z.KRISTAQ EKSARKO

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare, në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë z.Kristaq Eksarko.

2.Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2007, grupi 25, titulli 10 430, kap 1, artikulli 606 “Transferta të brendshme”, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3.Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.894, datë 29.12.2007

PËR DHËNIEN E NJË NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË SHTETASIT SAMI DOGA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare, në masën 1 000 000 (një milion) lekë, familjes së shtetasit Sami Doga.

2.Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2007, grupi 25, titulli 10 430, kap 1, artikulli 606, “Transferta të brendshme”, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të barabarta.

3.Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.895, datë 29.12.2007

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË KEI ROBERT KOÇIUT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007” të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare, në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë, familjes së Kei Robert Koçiut.

2. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2007, grupi 25, titulli 10430, kap 1, artikulli 606, “Transferta të brendshme”, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.896, datë 29.12.2007

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE PËR KURIMIN E Z.HAZIS META

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 8 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 850 000 (tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve për kurimin e z.Hazis Meta.

2.Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3.Pagesa të bëhet pas paraqitjes së faturave origjinale nga institucioni i kurimit.

4.Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe aparati i Këshillit të Ministrave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.897, datë 29.12.2007

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE, PËR KURIMIN E ZNJ.ARMINDA GJONI, NË TURQI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27, 11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- 1.Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 4 062 639 (katër milionë e gjashtëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë) lekësh, për përballimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin e znj.Armina Gjoni, në klinikën e patologjisë, në spitalin “Acibadem Hastanesi”, në Turqi.
 - 2.Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 - 3.Pagesat të bëhen pas paraqitjes së faturave origjinale nga institucioni i kurimit.
 - 4.Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.898, datë 29.12.2007

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE, PËR KURIMIN E ISH-DEKANIT TË FAKULTETIT TË MJEKËSISË, NË UNIVERSITETIN E TIRANËS, PROF.DR.KRISTO PANO

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- 1.Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 2 800 000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve për kurimin e ish-dekanit të Fakultetit të Mjekësisë, në Universitetin e Tiranës, Prof.Dr.Kristo Pano.
- 2.Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
- 3.Pagesa të bëhet pas paraqitjes së faturave origjinale nga institucioni i kurimit.

4.Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.921, datë 29.12.2007

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.108, DATË 11.2.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT, TË FUNKSIONIT DHE PAGAT E
PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT
TË PARAVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”, dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.108, datë 11.2.2005 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1.Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 7, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2.Pika 8, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Pozicioni	Kategoria	Paga individuale (Paga bazë)			Shtesa e pozicionit	Shtesa për kushte pune
		1	2	3		
Drejtor i përgjithshëm	II-a	10 050	2%	0	100 500	12 000
Zv/drejtor i përgjithshëm	II-b	10 050	2%	0	84 000	12 000
Përgjegjës sektori në drejtori	III-b	10 050	2%	0	49 000	15 000
Përgjegjës sektori mbështetës		10 050	2%	0	49 000	0
Specialist në drejtori	IV-a	10 050	2%	0	37 450	15 000
Specialist mbështetës	IV-a	10 050	2%	0	3750	0
	IV-b	10 050	2%	0	25 850	

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 21.7.2010

Doli nga shtypi më 23.7.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 36 lekë